



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 352 Prot.

Tiranë, më datë 15.07 2026

VENDIM
Nr. 92, datë 15.07.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 75 datë 19.02.2020 *“Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”*, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 15.07.2026, Këshilli Teknik:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit të potencialit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit *“Strukturë shërbimi dhe banimi 10, 11, 12, 13 dhe 14 kate mbi tokë, me 4 kate nëntokë”*, në pasurinë nr. 3/1031, 3/513, 3/1070, 3/951, 3/234, 3/952, zona kadastrale 8160, me vendndodhje në Tiranë, Bashkia Tiranë, në njësinë strukturore Tr/84, me zhvillues subjekti **“Magna Construction” sh.p.k.**;
2. Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, i ndryshuar, neni 145, pika 1 dhe nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen sipas përcaktimeve të neneve 145 pika 2 - 147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

